

Nazmije Shaqiri, MA<sup>1</sup>

Afrim Osmani, PhD<sup>2</sup>

Qebir Avziu, PhD<sup>3</sup>

UDC:

342.7-049.65(497.7)

**MBROJTJA KUSHTETUESE E TË DREJTAVE DHE LIRIVE  
PERSONALE TË NJERIUT DHE QYTETARIT NË MAQEDONI**

**УСТАВНА ЗАШТИТА НА ЛИЧНИТЕ ПРАВА И СЛОБОДИ  
НА ЧОВЕКОТ И ГРАЃАНИНОТ ВО РЕПУБЛИКА  
МАКЕДОНИЈА**

**THE CONSTITUTIONAL PROTECTION OF HUMAN AND  
CITIZEN PERSONAL RIGHTS AND FREEDOMS IN  
MACEDONIA**

**Abstract**

In a modern society as the one of today, the human rights and freedoms play an important role. The adoption of the Universal Declaration of Human Rights by the United Nations in 1948 after the Second World War proves the sensitization and commitment of the international community to the universal protection of human rights. Many countries, among them, the Republic of Macedonia as well, have incorporated into their constitutions norms referring to guaranteeing and protection of human rights. Therefore, this paper consists of analysis of the constitutional right in the Republic of Macedonia in the context of guaranteeing and protecting personal human and citizens' rights and freedoms and their implementation in practice.

---

<sup>1</sup> PhD candidate, University of Tetova- Macedonia (nazmije.shaqiri@unite.edu.mk)

<sup>2</sup> Faculty of law, University of Tetova – Macedonia (afrim.osmani@unite.edu.mk)

<sup>3</sup> Faculty of law, University of Tetova – Macedonia (qebir.avziu@unite.edu.mk)

The first part of the paper refers to human freedoms and rights in general and their classification into: *civil and political freedoms and rights*, where personal and political freedoms and rights are included and *economic, social and cultural rights*, while the main part of the paper refers to human personal freedoms and rights, such as: the right to life, the right of protection of human physical and moral integrity, the right to liberty, presumption of innocence, the right of protection, the right to privacy, the freedom of movement and choice of place residence and the right to citizenship. Republic of Macedonia meets the international standards set forth in various international acts referring to the protection of fundamental human rights and freedoms.

**Keywords:** human rights, constitutionality, personal rights and freedoms, The Universal Declaration of Human Rights, courts, ombudsman

### **Hyrje**

Ky punim ka për qëllim të diskutojë qëndrimin ndaj konceptit të prioritetit të të drejtave dhe lirive të njeriut, me theks të veçantë liritë dhe të drejtat personale, si parim i rëndësishëm ligjor dhe kushtetues. Shtetet në përgjithësi dallojnë në sistemet e tyre politike dhe ligjore, sa u takon formulimeve kushtetuese në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Të drejtat e njeriut luajnë rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë moderne. Burim i rëndësishëm i lirive themelore të njeriut është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila edhe 70 vjet pas ratifikimit luan rolin e saj, mirëpo përparimi teknologjik, shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, procesi dinamik i legjislacioneve, ndryshimi i vlerave shoqërore kanë bërë që të rishikohet koncepti i të drejtave të njeriut (Gumbis, J., Bacianskaite, V., & Randakeviciute, J., 2010).

Kombet e Bashkuara gjithnjë kanë qenë të fokusuar në zbatimin dhe përforcimin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, prandaj Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e ratifikuar në vitin 1948, paraqet themelin e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, e cila ngriti rëndësinë e të drejtave dhe lirive të njeriut për të gjithë njerëzit dhe kombet. Rëndësia e saj konsiston në faktin se shumë vende në mbarë botën parimet e saj i kanë inkorporuar në legjislacionin nacional dhe janë krijuar edhe mekanizma që kanë për qëllim monitorimin, promovimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, gjithsej 193 në numër, kanë ratifikuar më së paku një nga traktatet për të drejtat e njeriut, ndërsa mbi tridhjetë shtete kanë konfirmuar shprehimisht dedikimin e tyre ndaj kësaj deklarate në rendin e tyre kushtetues (Barkett, 2016). Megjithatë, për shumë njerëz në mbarë botën mbrojtja e të drejtave të njeriut ngelet një premtim i paplotësuar, sepse pavarësisht faktit se jetojmë në një kohë ku mendohet se të drejtat e njeriut respektohen në nivel global, respektimi dhe mbrojtja e tyre dallon nga shteti në shtet, ndërsa në anën tjetër, asnjë periudhë tjetër historike nuk ka dëshmuar shkelje më të mëdha të këtyre të drejtave.

Meqë kjo deklaratë u miratua në formë të Rezolutës dhe jo në formë të traktatit ndërkombëtar, shtetet për zbatimin e saj morën obligim moral dhe jo detyrim ndërkombëtar, megjithatë parimet themelore për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut mund t'i gjejmë në kushtetutat dhe legjislationet e shumicës së shteteve, sepse ato parime tashmë janë parakusht për përfshirje në legjislationet nacionale për shtetet që pretendojnë integrimin në strukturat Euro-Atlantike. Deklarata dallohet nga tekstet tjera klasike për të drejtat e njeriut, sepse për herë të parë provon të ndërlidhë të drejtat civile e politike dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (Gruda Z, 2007).

Çdo shtet është ndërkombëtarisht i obliguar që të garantojë të drejtat themelore të njeriut, ku mes këtyre të drejtave është e drejta për jetë nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat tjera njerëzore.

Në teori ekzistojnë koncepte të ndryshme në lidhje me konceptin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit. Sipas konceptit të së drejtës natyrore, njeriu lind i lirë dhe me vetë lindjen ai është bartës i lirive dhe të drejtave, të cilat nuk mund t'i merren ose kufizohen, por shteti duhet vetëm t'i mbrojë ato. Sipas konceptit tjetër, konservativ-etatistik, shteti është faktori i cili qytetarëve të vet u garanton liri dhe të drejta të caktuara, si dhe të njëjtat mund t'i kufizojë. Ndërsa tani në teorinë kushtetuese dhe politike, liritë dhe të drejtat i përcakton kushtetuta e një shteti, si akt me të cilin krijohen, garantojnë dhe mbrohen liritë dhe të drejtat (Климовски, 1997).

### **1. Mbrojtja e të drejtave të njeriut në bazë të Kushtetutës së Maqedonisë**

Kushtetuta nënkupton aktin më të lartë juridiko-politik me anë të së cilës përcaktohen dhe mbrohen vlerat themelore të një shteti. Autori Duhamel (1993), Kushtetutën e përkufizon sipas kuptimit material dhe

formal edhe atë: “Kushtetuta sipas kuptimit material përfshinë tërësinë e rregullave në lidhje me dhënien dhe ushtrimin e pushtetit politik, ndërsa kushtetuta sipas kuptimit formal nuk është gjë tjetër veçse tërësia e rregullave të formuluar në formë kushtetuese, të grupuara në një ose disa tekste të veçanta që kanë një vlerë më të lartë se të gjitha normat tjera [...] dhe që mund të ndryshohen vetëm në një procedurë të veçantë që quhet rishikim”.

Vend të rëndësishëm në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë – si kushtetutë liberale demokratike kanë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, si shtet multi-etnik parasheh se: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore”.

Normat kushtetuese kushtuar lirive dhe të drejtave do të përbënin vetëm një deklaratë ku do të proklamoheshin këto të drejta, nëse me dispozitë kushtetuese nuk do parashihej e drejta e shtetasit që të kërkojë mbrojtjen e atyre lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të RM-së (neni 50), që paraqet garanci për realizimin e tyre në praktikë (Maksuti, 2010).

## **1.2. Roli i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut**

Sa u takon mekanizmave ndërkombëtarë, vend të rëndësishëm ka Konventa Evropiane e cila është një traktat i nxjerrë nga Këshilli i Evropës, i miratuar në vitin 1950, ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 1953 dhe për bazë ligjore ka Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut ku njëkohësisht ishte instrumenti parë që do të vinte të zbatim të drejtat e parapara në të dhe t’i bëjë ato të detyrueshme. Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën në vitin 1997. Që nga miratimi i saj në vitin 1950, Konventa është ndryshuar disa herë dhe plotësuar me shumë të drejta si shtesë e atyre të drejtave në tekstin origjinal dhe jo të gjitha shtetet i kanë ratifikuar protokollet tjera të hartuara më vonë. Rëndësia e kësaj konvente qëndron në faktin se është dokumenti i parë që rregullave deklarative u ka dhënë karakter të detyrueshëm dhe se hyrja në Këshill të Evropës kushtëzohet me respektimin e të drejtave të njeriut.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut garanton të drejtat dhe liritë e veçanta dhe ndalon

praktikat e padrejta dhe të dëmshme. Ajo përfshin: të drejtën për jetën, lirinë nga tortura, lirinë nga skllavëria, të drejtën për liri, të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit, të drejtën për tu martuar dhe për të krijuar familje, të drejtën për të mos u diskriminuar në lidhje me këto të drejta, të drejtën për mbrojtje të pronës, të drejtën për arsim, të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje të lira, të drejtën për mos u dënuar për një vepër penale që në kohën kur është kryer nuk përbente vepër penale, heqja e dënimit me vdekje.

Për respektimin e detyrimeve nga ana e shteteve si dhe sa u takon organeve për ushtrimin e kësaj detyre, Konventa ka siguruar mekanizmin politik e gjyqësor, përmes Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, roli i së cilës është vendimtar për garantimin e këtyre të drejtave (Puto, 2008).

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe shtetasit, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë i ndanë në dy kategori:

- liri dhe të drejtat civile dhe politike ku janë të përfshira liritë dhe të drejtat personale dhe liritë politike;
- të drejtat ekonomike, sociale e kulturore.

## **2. Liritë dhe të drejtat personale të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë**

Liritë dhe të drejtat personale padyshim se janë kategori e të drejtave të cilat përbëjnë grupin më të rëndësishëm të të drejtave të cilat i garanton Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, të cilat mbrojnë dhe shprehin integritetin fizik dhe shpirtëror të njeriut dhe pozitën e tij juridike në shoqëri.

Sipas konceptit filozofik në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ku mbështetet teoria e të drejtës natyrore, njeriu lind i lirë me të drejta të caktuara natyrore të cilat nuk ia ka dhuruar askush, por i takojnë, sepse është qenie njerëzore. Shteti është i obliguar ato të drejta t'i respektojë, nuk mund t'i heqë apo t'i shkelë ato, mirëpo këto të drejta nuk janë absolute, sepse shteti me aktet e tij, nëse vijnë në shprehje interesi publik i përgjithshëm, mund t'i kufizojë këto të drejta (Anastasi, 2003).

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë sa i takon kësaj grupe të të drejtave, garanton disa të drejta, edhe atë:

### **2.1. E drejta në jetesë si e drejtë fundamentale e njeriut**

Të drejtën në jetesë e mbrojnë aktet ndërkombëtare edhe ato nacionale. Kështu, mund të veçojmë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950), e cila ka pasur ndikim tejet të rëndësishëm në rregullimin e të drejtave të njeriut edhe në vendin tonë. Këtu hyjnë edhe e drejta në jetesë e cila është objekt rregullimi i konventës dhe duhet të konsiderohet si e tërë sepse të drejtat e përfshira në këtë instrument nuk mund të veprojnë veçmas nga njëra tjera. Konventa në nenin 2, parasheh se: “Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykate, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj” (Agalliu, 2018). Sipas konventës, nuk do të ishte e kundërligjshme marrja e jetës në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, në rastet e mbrojtjes së çdo personi nga dhuna e paligjshme; për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht apo për të kundërshtuar në përputhje me ligjin një trazirë ose kryengritje (neni 2).

Tek të drejtat personale, e drejta në jetesë zë vendin e parë, dhe ky status ligjor i kësaj të drejte logjikisht rrjedh nga vetë jeta si një vlerë pa të cilën nuk ka të drejta tjera të garantuara. Jeta si vlerë e cila mbrohet nga kjo e drejtë nuk ka mbrojtje të barabartë universale në nivel ndërkombëtar, por edhe në sistemin ligjor nacional ndryshon (Орловић, 2014).

Të drejtën në jetesë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e rregullon në atë formë që parasheh se jeta e njeriut është e pacenueshme dhe se në Republikën e Maqedonisë nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje sipas asnjë baze (neni 10).

Jeta e njeriut si vlera më e shtrenjtë për njeriun, mbrohet me rregulla të së drejtës penale nga momenti i lindjes, deri në momentin e vdekjes. Qëllimi i kushtetutës, kodit penal dhe akteve tjera juridike është të mbrojnë jetën e njeriut në çdo fazë të tij, pavarësisht plakjes apo kualitetit të tij, nga çdo sulm ndaj tij. Në të drejtën penale, ekzistojnë katalog i veprave penale, ku parashihet mbrojtja e jetës së njeriut dhe mbrojtja e foshnjës së palindur (Drakić, 2013).

E drejta në jetesë është themeli i të drejtave personale të njeriut. Njeriu është pronar i jetës së tij dhe askush nuk mund të vendos për jetëgjatësinë dhe mënyrën e jetesës së tij, përveç në rastet e parapara me ligj, siç u tha edhe më sipër.

### ***2.2. E drejta në mbrojtjen e integritetit fizik dhe moral të njeriut***

Kjo e drejtë nënkupton të drejtën që secili njeri të mbrojë integritetin e vet fizik dhe lirshëm të vendos për zhvillimin moral të tij. Duke u frymëzuar nga Deklarata Universale e të Drejtave të njeriut, shumë shtete demokratike, mes tjerash edhe shteti ynë, në rendin e tyre kushtetues njohin parimin e dinjitetit të njeriut si e drejtë themelore (Sourlas, 2016). Kështu, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë integritetin fizik dhe moral e rregullon në dy mënyra: e para garanton pacenueshmëri të integritetit fizik dhe moral të njeriut dhe ndalon çdo formë të torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues, si dhe punën me detyrim (neni 11), dhe e dyta, çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit (neni 25).

Po ashtu, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 3 dhe 4 ndalon ushtrimin e torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese si dhe ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar.

Si organet shtetërore ashtu edhe çdo qytetarë tjetër është i obliguar të respektojë integritetin fizik dhe moral të njeriut, sepse kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë dhe e mbron qytetarin nga çdo lloj maltretimi, pavarësisht nëse gjendet në liri, në paraburgim apo burg. Kjo e drejtë është e pacenueshme, në të njëjtën masë siç është e pacenueshme e drejta në jetesë (Шкарпик, 1995).

### ***2.3. E drejta për liri***

E drejta për liri është e garantuar me akte ndërkombëtare dhe Kushtetutën e RM-së. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën për liri, si e drejtë në lirinë e lëvizjes, e veprimt dhe sjelljes.

E drejta për liri si e drejtë themelore e njeriut në bazë të së cilës realizohen të gjitha të drejtat tjera paraqet edhe një dëshmi të humanizmit dhe demokracisë së arritur në praktikë pas një luftë shekullore të njeriut për të drejtën themelore të lirisë.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 12, garanton të drejtën në liri. Domethënë, askujt nuk mund t'i kufizohet liria, përveç me vendim të gjykatës dhe në raste dhe procedura të caktuara me ligj. Kjo dispozitë drejton në respektimin e parimeve ligjore kur bëhet fjalë për heqjen nga liria.

Paraburgimi, deri në ngritjen e akuzës, me vendim të gjykatës mund të zgjasë më së shumti 180 ditë nga dita e paraburgimit. Pas ngritjes së akuzës, paraburgimin e vazhdon ose e përcakton gjykata kompetente në rastin dhe me procedurë të përcaktuar me ligj (neni 12, amendamenti III). Përcaktimi i kompetencave të gjykatës nënkupton besimin në një organ objektiv i cili do të vendos për fajësinë e personit.

Garanci kushtetuese me rëndësi të veçantë përmbajnë dispozitat të cilat e rregullojnë procedurën e privimit nga liria. Domethënë, personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë të njoftohet me shkaqet për thirrjen, arrestimin ose privimin e tij nga liria dhe me të drejtat e tij të caktuara me ligj dhe prej tij nuk mund të kërkohet deklaratë. Njëkohësisht, personi ka të drejtë në mbrojtës në procedurën policore dhe gjyqësore (neni 12, alineja 3).

Me rëndësi të veçantë gjatë heqjes së lirisë, është parakushti për urgjencë në procedurën e paraburgimit. Personi i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të nxirret para gjykatës, e cila pa shtyrje do të vendosë për ligjshmërinë e privimit nga liria (neni 12, alineja 4). Përndryshe personi i paraburgosur, në kushte të caktuara me ligj, mund të lëshohet të mbrohet nga liria (Pollozhani, 2011).

#### **2.4. Presumimi i pafajësisë**

Presumimi i pafajësisë është parim i rëndësishëm kushtetues dhe shprehje e respektimit të personalitetit të njeriut.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 7, thekson se askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

Kështu, askush nuk mund të dënohet për vepër e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar me ligj ose normë tjetër si vepër penale dhe për të cilën nuk ka qenë i parashikuar dënim si dhe askush nuk mund të gjykohet sërish për vepër për të cilën ka qenë i dënuar një herë dhe për të cilën është marrë vendim i plotfuqishëm gjyqësor (neni e 14). I pandehuri do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk do të vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor (Lemos, 2006).

Nisur nga kjo, ekziston shprehja latine *nullum crimen, nulla poene, sine lege*, e cila në mënyrë eksplicite e proklamoi ndalimin për



të dënuar për vepër e cila është kryer në kohën kur nuk është paraparë si vepër penale dhe nuk është paraparë dënim, pavarësisht nëse më vonë është shpallur si e dënueshme (Климовски, 1997).

### **2.5. E drejta në mbrojtje**

Një tjetër e drejtë rëndësishme e njeriut e garantuar me Kushtetutën e Maqedonisë është edhe e drejta në mbrojtje, e cila kryesisht ka të bëjë me realizimin e të drejtave të njeriut në procedurat para organeve shtetërore.

Në favor të shfrytëzimit të kësaj të drejte funksionon avokatura e cila sipas Kushtetutës tek ne është shërbim publik i mëvetësishëm dhe i pavarur, që ka për obligim të sigurojë ndihmë juridike dhe të ushtrojë autorizime publike në pajtim me ligjin (neni 53).

Kjo e drejtë më së shumti do të vijë në shprehje gjatë përcaktimit të paraburgimit, që domethënë se secili person i cili kërkon mbrojtje të të drejtave të tij, është i obliguar që me parashtrimin e kërkesës, argumentimin juridik të saj, gjatë zhvillimit të saj t'i paraqes faktet relevante gjatë procedurës, ngritjen e ankesës kundër vendimit të shkallës së parë dhe ndërmarrjen e veprimeve tjera në pajtim me ligjin (Maksuti, 2010).

### **2.6. E drejta e privatësisë**

Kjo e drejtë nënkupton të drejtën e çdo njeriu në jetën e tij personale dhe familjare mos shqetësohet dhe përveç që përfshin mbrojtjen nga përgjimi i telefonit dhe bisedave tjera me të cilat fyhen interesat personale dhe shpalosen sekretet personale, por edhe formën e indis-krecionit dhe bastisjen e gjërave personale (Saliu, 2002).

Qasja e lehtë në rrjete sociale, në kushtet bashkëkohore ka bërë që mundësia për keqpërdorimin e të dhënave personale dukshëm të rritet, prandaj kjo ndikon që shumë më lehtë të shkelet kjo e drejtë kushtetuese.

Në pajtim me këtë Kushtetuta e Maqedonisë në nenin 25 i garanton çdo qytetari respektimin dhe mbrojtjen e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe autoritetit. Në këtë drejtim, garantohet siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale, mbrojtja nga cenimi i integritetit personal, që buron nga regjistrimi i informatave për ta përmes përpunimit të të dhënave.

Duke u nisur nga fakti se në vitin 2001, në vendin tonë ndodhi përgjim masiv i politikanëve dhe gazetarëve, atëherë kur përgjimi ishte i ndaluar me kushtetutë, kryetari i shtetit i fali personat e dyshuar për

përgjim (Maksuti, 2010), ndërsa në vitin 2003 u nxor amendamenti XIX, i cili e ka zëvendësuar nenin 17 të Kushtetutës. Me amendamentin XIX garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit, ndërsa vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe të gjitha formave tjera të komunikimit nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të pengimit ose zbulimit të veprave penale, zhvillimit të procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë.

### **2.7. Liria e qarkullimit dhe e zgjedhjes së vendbanimit**

Liria e qarkullimit dhe e zgjedhjes së vendbanimit nënkupton të drejtën e qytetarit që të qarkullojë lirshëm dhe të zgjedh vendbanimin. Kjo e drejtë kushtetuese vlen për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë që të mund të lëvizin lirisht në territorin e Republikës dhe lirisht të mund ta zgjedhin vendbanimin e tyre. Në funksion të kësaj të drejte qytetarit i garantohet e drejta që ta lëshojë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe të kthehet përsëri kur të shprehë dëshirë. Në anën tjetër, kjo e drejtë nuk mund të trajtohet si e drejtë absolute sepse ka raste kur ajo mund të kufizohet me ligj edhe atë kur ajo është e nevojshme me qëllim të mbrojtjes së sigurisë së Republikës së Maqedonisë, zhvillimit të procedurës penale ose mbrojtjes së shëndetit të njerëzve (neni 27).

### **2.8. E drejta e shtetësisë**

Shtetësia paraqet lidhjen e përhershme juridike politike të personit fizik me një shtet të caktuar dhe në bazë të kësaj qytetari bëhet subjekt i një vargu të të drejtave dhe detyrave në raport me shtetin, andaj si rrjedhojë e kësaj personi fizik në pikëpamje formale juridike i gëzon të drejtat civile, politike, ekonomike-sociale, pavarësisht a gjendet në territorin e shtetit të vet apo territorin e shtetit të huaj (Bilalli, A. & Kuçi, H., 2012).

Duke u nisur nga kjo që u tha më sipër, personat fizik të cilët i gëzojnë këto të drejta dhe detyrime dhe i nënshtrohen juridiksionit shtetëror, quhen *shtetas* (Ismaili, 2004). Qytetari mund të jetë shtetas i më shumë shteteve (bipatrid), mirëpo mund të ngelë edhe pa asnjë shtetësi (apatrid).

Kushtetuta çdo qytetarit i garanton të drejtë në shtetësi të Republikës së Maqedonisë, ndërsa neni 4, alineja 2 përbën garanci për shtetasit e vendit të saj, që domethënë se shtetasit të Republikës së Maqedonisë nuk mund t'i hiqet shtetësia, as të dëbohet ose t'i dorëzohet shtetit tjetër.

Më për së afërmi, çështjet që kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat për fitimin e shtetësisë dhe ndërprerjen e shtetësisë i rregullon Ligji për shtetësi (1992) të Republikës së Maqedonisë.

### **3. Institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Maqedoni**

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut sipas Kushtetutës realizohet përmes parimit të sundimit të së drejtës (neni 8), përmes procedurës së mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës, garantimit të mbrojtjes gjyqësore të ligjshmërisë së akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike dhe krahas kësaj çdo qytetar ka të drejtë të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 50).

Në Republikën e Maqedonisë, institucione më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë gjykatat e rregullta, Gjykata kushtetuese, Avokati i popullit, Komisioni i përhershëm anketues në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe qytetarit e të tjera.

Gjykatat e rregullta paraqiten si institucione më të thirrura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ligji mbi gjykatat (2006) përcakton edhe kufizimin e kompetencave të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës kushtetuese të RM-së, ashtu që gjykatat e rregullta kanë kompetencë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, vetëm nëse nuk është kompetente Gjykata Kushtetuese. Kompetenca e kësaj gjykate ka për qëllim mbrojtjen e parimit të kushtetutshmërisë – mbron të drejta konkrete të njeriut që janë kategori kushtetuese si dhe rastet kur organet shtetërore nuk kanë vepruar konform kornizës ligjore, por kanë cenuar të drejtat e njeriut. Megjithatë, Gjykata kushtetuese e RM-së ka pasur qasje restriktive dhe ka paraparë kufizim në lidhje me mbrojtjen e të drejtave, sepse nuk i mbron të gjitha të drejtat kushtetuese, por vetëm lirinë e bindjes, ndërjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike (Kadriu, B., & Ahmedi, B., 2015).

Kompetencat e Avokatit të popullit sa u takon mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dalin nga Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e popullit (2003), ku krahas mbrojtjes së të drejtave të qytetarit, ky institucion ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet shtetërore.

Avokati i popullit përcjell rastet në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave, të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes, në organe, organizata apo ente (neni 31), sidomos të personave të arrestuar, të paraburgosurve dhe personave tjerë të cilët vuajnë dënim me burg apo gjenden në ente ndëshkuese përmirësuese dhe edukative përmirësuese duke vuajtur masën edukative përmirësuese. Avokati i popullit kryen parandalim dhe siguron mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, parandalim dhe mbrojtje nga tortura apo trajtim tjetër mizor, jonjerëzor apo nënçmuese në vendet ku personave u është kufizuar liria, jodiskriminim dhe përfaqësim i drejtë si dhe mbrojtja nga zvarritja e paarsyeshme e proceseve gjyqësore ose të kryerjes së punëve me papërgjegjësi dhe pa ndërgjegje në shërbimet gjyqësore (neni 12).

#### 4. Conclusion

The conclusion that can be drawn from this paper is that human rights and freedoms must be guaranteed and protected by law. It is necessary that the cases when the restraints of these rights are legitimized are defined through legal provisions, in order to effectively ensure the enjoyment of these rights and prevent abuse by the state authorities. As it can be seen the Republic of Macedonia meets the international standards set forth in various international acts referring to the protection of fundamental human rights and freedoms. The Constitution guarantees the citizens of Macedonia equality before the Constitution and the laws; they are equal in their freedoms and rights regardless of gender, race, skin color, national and social origin, political and religious beliefs, social and property position. The Constitution prohibits any form of torture, conduct and inhuman degrading and punishment or forced labor. Physical and moral integrity, as well as human life, are inviolable, from which no death penalty can be imposed on any basis.

What is important in this regard is the dilemma whether the constitutional provisions are implemented in practice; if all citizens equally enjoy these rights regardless of their ethnic affiliation, gender,

race, skin color, political and religious beliefs, social and property position, therefore, strong legal mechanisms should be established that guarantee equal access to the rights and freedoms and national equality for all citizens. Human rights and freedoms as standards must be respected and incorporated in all spheres of everyday human life, and the state has a fundamental obligation towards the citizen to promote and guarantee the same through institutionalized means.

### **Bibliografia**

Agalliu, P. (2018). Boundaries and restrictions of "The right to life" according to the European Court of Human Rights (Article 2 of ECHR) jurisprudence. *Academic Journal Of Business, Administration, Law & Social Sciences*, 4(1), 50-61.

Anastasi, A. (2003). *E drejta Kushtetuese (cikël leksionesh)*. Tiranë: Pegi.

Barkett, R. (2016). "BRINGING HUMAN RIGHTS HOME"? I THOUGHT THEY WERE ALREADY HERE! HUMAN RIGHTS AND OUR CONSTITUTION. *New York University Law Review*, 91(3), 535-558.

Bilalli, A. & Kuçi, H. (2012). *E drejta ndërkombëtare private: pjesa e përgjithshme*. Prishtinë: UP.

Drakić, D. (2013). Criminal Law Protection of the Right to Life that is „Not Worth Living“. . *Proceedings Of Novi Sad Faculty Of Law, Novi Sad*, 47(1), 229-244.

Duhamel, O. (1993). *E drejta kushtetuese - demokracitë*. Shkup: Logos A.

Gruda Z. (2007). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. Shkup: Furkan ISM.

Gumbis, J., Bacianskaite, V., & Randakeviciute, J. (2010). HUMAN RIGHTS TODAY. *Jurisprudencija*, 1(119), 125-145.

Ismaili, O. (2004). *Fillet e së drejtës*. Prishtinë: UP.

Kadriu, B., & Ahmedi, B. (2015). CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA: A REPRESENTS AN INSTITUTION OF PROTECTION OF HUMAN RIGHTS. *Vizione*, 23147-160.

Lemos, M. H. (2006). The Commerce Power and Criminal Punishment: Presumption of Constitutionality or Presumption of Innocence? *Texas Law Review*, 84(5), 1203-1264.

Maksuti, M. (2010). *E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë*. Tetovë: Arbëria Design.

Pollozhani, B. (2011). *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës*. Shkup: Furkan ISM.

Puto, E. (2008). *E drejta Kushtetuese e krahastuar*. Tiranë: UFO.

Saliu, K. (2002). *E drejta Kushtetuese*. Tetovë.

Sourlas, P. (2016). Human Dignity and the Constitution. *Jurisprudence*, 7(1), 30-46.

Климовски, С. (1997). *Уставен и политички систем*. Скопје: Просветно дело.

Орловић, С. П. (2014). ПРАВО НА ЖИВОТ У УСТАВУ - ЕКОЛОШКИ УГАО. *Proceedings Of Novi Sad Faculty Of Law, Novi Sad*, 48(4), 161-175.

Шкарик, С. (1995). *Уставно право*. Скопје: Union-trade.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. (1950). Romë: Këshilli i Evropës.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS I-XXXII). (1991). Shkup: Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë (52/91; 1/92; 31/98; 91/01; 84/03; 107/05; 3/09; 13/09; 49/11).

Ligji për shtetësi. (1992). Shkup: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë (67/92; 08/04; 98/08; 158/11).

Ligji për Avokatin e popullit. (2003). Shkup: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë (60/03; 114/09; 181/16; 189/16).

Ligji mbi gjykatat. (2006). Shkup: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë (58/06; 35/08; 150/10).